

Bëjmë thirrje të gjithë refugjatëve, që janë bllokuar në kufi midis Francës dhe Anglisë.

Me qëllim të vazhdojnë politikën e tyre së shfrytëzimit të njerëzve në interes të pasurve, qeveritë evropiane kanë zbatuar ligjet dhe rregullat kundër refugjatëve. Dhe vetëm një qëllim kanë këto ligje, të krijojnë frikë dhe pasiguri në menyrë të jenë me dorë të plotë për të marrë votat e injorantëve dhe racistëve. Ashtu kufizojnë të drejtat për azil politik, mbyllin refugjatë në qendra, i kthejnë në vendet e tyre ; policia kryen veprat të dhunshme dhe të lejuara nga shteti.

Kontratët dhe kolaboracioni i policisë midis qeverisë angleze dhe franceze shkelin ligjin e Gjenevës që njeh drejtin e të gjithëve të largohen nga një vend dhe të kërkojnë azil politik në një tjetër, si Franca ose Anglia, që kanë firmosur atë ligji.

Ne, si militantë, politikanë, vullnetarë nga shumë shoqata të ndryshme, dhe njerëz e thjeshtë, të neveritur nga politikat evropiane për emigrimin dhe nga pasojat politike për punëtorët në të gjithë botë, ne vendosëm të organizojmë një kamp “Pa kufi”, nga 23 qershor deri më 30 qershor 2009 në Kalajsë.

Në këtë kamp do bashkohen të gjithë luftat e kryera për çështjen e refugjatëve : të ndalojmë burgimin dhe kthimin e emigrantëve pa document ; dhe që çdo njeri të shkojë ku të dojë, pa kufi.

Në Kalajsë, ne duam të denoncojmë situatën tuaj, faktin që jeni bllokuar në kufi, ndaluar të kaloni në Angli, detyruar të jetoni më kushtete panjerëzore, përballuar çdo ditë me dhunën e policisë. Edhe denoncojmë politikat e emigrimit të Francës, të Anglisë dhe të gjithë vendeve evropiane ; qendrat në të cilat jeni burgosur, frikësuar dhe privuar nga të drejtat tuaja.

Militantët nga Anglia, nga Franca dhe nga Belgjika bashkohen për të denoncuar këtë situatë panjerëzore e vënë mbi popujt nga qeveritë evropiane.

Ju ftojme të gjithë të vini në këtë kamp, që të diskutojmë bashkë, që të ndani eksperiencat tuaja, që të informoheni për të drejtat tuaja, që të shprehni për vete dhe që të bëni pjesë në manifestimet për të denoncuar këtë situatë.

Po ju kërkojmë, ju emigrantët e Kalajsës, të bashkoheni me neve për të kërkuar lirinë, hapjen e kufirit, mbylljen e qendrave, dhe që të gjithë të kenë të drejta të barabartë. Në një vend demokratik, krijuar që të jenë të gjithë për mire, çdo punëtorë ka vendin e tij, nuk ka qytetarët “e paligjishmë” ose “e padëshiruar”.

Bashkoheni me neve, dhe të gjithë bashkë të krijojmë mundësinë, që çdo person të shkojë në vendin ku dëshiron të jetojë.